Kronikë

Vlorë, qëlloi me kallashnikov në ajër, arrestohet 42-vjeçari

Një 42-vjeçar është vënë në pranga nga policia pasi ditën e djeshme dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri kallashnikov në Karaburun, në afërsi të stanit të tij duke rrezikuar jetën e banorëve.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
5 Prill, 12:07 | **Përditesimi: 5 Prill, 12:21**

Share

Një 42-vjeçar është vënë në pranga nga policia pasi ditën e djeshme dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri kallashnikov në Karaburun, në afërsi të stanit të tij duke rrezikuar jetën e banorëve.

> *'Finalizohet nga shërbimet e Stacionit të Policisë Orikum, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Vlorë dhe Delta Force, operacioni policor i koduar "Strike 9", për goditjen e një rasti të armëmbajtjes pa leje.*
>
> *Vihet në pranga një 42-vjeçar që qëlloi me armë zjarri në ajër, në Karaburun, duke rrezikuar banorët e zonës.', thuhet në njoftimin e policisë.*

LEXO EDHE:
Riaktivizohen flakët në 'Bar Lulishte Butrinti', ekspertë nga Tirana në Sarandë të hetojnë shkaqet! Qytetarët: E shkatërruan për të ndërtuar

A.J., banues në Dukat qëlloi në ajër me kallashnikov në Karaburun në vendin e quajtur 'Gallolec'. Policia pas njoftimit organizoi operacionin 'Strike 9' në kuadër të të cilit u arrestua 42-vjeçari në flagrancë. Gjithashtu u sekuestrua edhe arma e zjarrit kallashnikov, e cila u gjet në stanin e të arrestuarit.

> *'Ky shtetas dyshohet se ditën e djeshme, ka qëlluar me armë zjarri kallashnikov, në Karaburun, në afërsi të stanit të tij, duke rrezikuar banorët e zonës. Shërbimet e Policisë gjatë kontrollit në këtë zonë kanë gjetur të fshehur dhe kanë sekuestruar në cilësinë e provës materiale armën e zjarrit kallashnikov, një krehër dhe municion luftarak.*
>
> *Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.', thuhet më tej në njoftimin e policisë.*

G.K/S.Ç/Shqiptarja.com

TAG: Vlore karaburun

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Dumani raportoi para KLP, çvlerësim keni ju për punën e SPAK-ut?

Pozitiv Negativ Asnjanës

Lajme të tjera

Po peshkonte me lëndë plasëse, 56 vjeçarit i gjejnë 3 kallëpë tritoli
5 Prill, 14:21

Dokument ekskluziv/ Vlora pa landfill, KLSH 'zbarkon' në Bashki, kërkon përgjegjësit për Sherishtën!
Armand Xhelili
5 Prill, 12:20

Digjet 'Bar Lulishte Butrinti" në qendër të Sarandës! Bashkia prej vitesh e la në degradim! Shpëtohet pema e Piperit e mbjellë nga Naim Frashëri (Video)
Limos Didani
5 Prill, 10:20

'Kanë pamje nga vilat e Trampit', çmenduria në Vlorë, rriten deri në 200 euro për m2 banesat nga ku shihet Sazani
4 Prill, 19:59

Lidhja e Rrugës Transballkanike me portin e Vlorës, nis shembja e objekteve që preken nga projekti
4 Prill, 16:05

Raporti i SPAK: Veçoritë e grupeve kriminale shqiptare nga Shkodra, në Vlorë! Harta ku veprojnë! Të përfshirë dhe biznesmenë të fuqishëm, lidhje me policë e funksionarë të drejtësisë
4 Prill, 15:31

I vodhën kartat bankare dhe para një personi, dy në pranga në Vlorë
4 Prill, 14:45

Pësون defekt teknik, peshkarexha mbetet në det të hapur disa milje larg Sazanit! Policia Kufitare u shkon në ndihmë 3 marinarëve
4 Prill, 07:54

'Do të publikoj foto intime', 38-vjeçarja kallëzon 21-vjeçarin në polici: Më ka kanosur dhe përndjekur! Vihet në pranga i riu në Vlorë
3 Prill, 13:24

VIDEO/ Uji i kristaltë, pamjet mahnitëse nga 3 ishujt në Ksamil! Rama: Gati për të pritur pushues nga e gjithë bota
3 Prill, 08:36

Zjarr në një banesë në lagjen '29 Nëntori' në Vlorë, vdes i moshuari tetraplegjik (EMRI)
2 Prill, 18:12

Vlorë, 5 vatra zjarri në 72 orë, shefi i Ndërbyrjes në Zjarrfikëse: Situatë problematike, janë favorizuar nga era!
Armand Xhelili
2 Prill, 10:22

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje